

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7872
E enjte, 29 gusht 2024
Çmimi 0.50 €

Hoxhaj kritikon Qeverinë Kurti: Nuk ka siguruar asnjë njohje dhe asnjë anëtarësim të vetëm



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KTHIMI I TRUMPIT APO FITORJA E HARRISIT? JOSEPH: BALLKANIN MUND TA PRESIN NDRYSHIME



Edward P. Joseph, ligjërues në Universitetin Johns Hopkins në ShBA, flet në një intervistë për Radion Evropë e Lirë për ndikimin që mund ta ketë rezultati i zgjedhjeve në Shtetet

e Bashkuara në Ballkanin Perëndimor. Joseph thotë se rikthimi i mundshëm i Donald Trumpit në presidencë, mund të çojë në ndryshime drastike në politikën

e jashtme të ShBA-së. Në atë rast, ai nuk e përjashton mundësinë e një marrëveshjeje me Rusinë për Ukrainën, që, siç thotë, do të ndikonte drejtpërdrejt në Ballkan

25 PROFESORË UNIVERSITARE I KËRKOJNË KURTIT E HAXHIUT T'I HEQIN KUFIZIMET PËR MBROJTJEN E KRERËVE TË UÇK-SË NË HAGË



KËRKOHEM NGA PRESIDENTJA OSMANI DHËNIA E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E TRI MARRËVESHJEVE ME SUE DINË



AKTUALE



KURTI: PO BËJMË TË GJITHA KONSULTIMET E NEVOJSHME PËR HAPJEN E URËS

PAGA MINIMALE NË KOSOVË RRI TET NË 350 EURO

AKTAKUZË E RE KUNDËR TRUMPIT PËR ZGJEDHJET PRESIDENCIALE TË VITIT 2020

EKONOMI



TREÇA SHPALL GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME

KESCO SHPËRNDAN FATURAT E RRYMËS NË ZARFE PËR MBI 700 MIJË KONSUMATORË

SPORT



SHKËNDIJA KONFIRMON NNDARJEN ME KRASNIQIN

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Aktakuzë e re kundër Trumpit për zgjedhjet presidenciale të vitit 2020

WASHINGTON, 28 GUSHT - Prokurori i Posaçëm amerikan, Jack Smith, ka ngritur aktakuzë të re kundër ish-presidentit amerikan, Donald Trump, për dyshimet se ai ishte përpjekur ta zhbënte rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020.

Aktakuza e re e ngarkon Trumpin me akuzat e njëjta kriminale sikurse ajo e vjetra, por përmban disa ndryshime pas aktvendimit të Gjykatës Supreme se ish-presidenti gëzon imunitet të gjerë nga ndjekja penale.

Aktakuza e re përqendrohet në rolin e Trumpit si kandidat politik që kërkonte rizgjedhjen, në vend se si president i vendit asokohe.

Më 1 korrik, Gjykata Supreme tha se Trumpi gëzon imunitet nga ndjekja penale për veprimet që i kishte ndërmarrë si president.

Zyra e Prokurorit të Posaçëm tha se aktakuza e përditësuar, e dorëzuar në gjykatën federale në Uashington,

“pasqyron përpjekjet e Qeverisë për t'i respektuar dhe zbatuar vendimet e Gjykatës Supreme”.

Në një reagim në platformën e vet Truth Social, Trump e quajti

aktakuzën e re “dëshpërim” dhe “përpjekje për ta ringjallur gjuetinë e vdekur të shtrigave”. Ai tha se aktakuza e re i ka “të gjitha problemet e aktakuzës së vjetër dhe duhet të hidhet poshtë menjëherë”.

Aktakuza e re i heq referencat ndaj akuzave të cilat mund të cilësohen si veprime zyrtare për të cilat Trumpi gëzon imunitet, sipas vendimit të Supremes. Kjo përfshin akuzat se Trumpi u përpoq ta përdorte Departamentin e Drejtësisë në përpjekjet e tij të dështuara për ta zhbërë humbjen në zgjedhje, përfshirë duke kryer hetime të rrejshme dhe duke u thënë shteteve - gabimisht - se është vërejtur mashtrim i madh në zgjedhje.

Gjykata Supreme tha në vendimin e saj se bashkëveprimi i presidentit me Departamentin e Drejtësisë është veprim zyrtar dhe për këtë ai gëzon imunitet.

Aktakuza e re heq edhe referencat ndaj komunikimit të Trumpit me zyrtarët e qeverisë federale si avokatë të lartë të Shtëpisë së Bardhë - të cilët i kishin thënë atij se nuk kishte dëshmi për mashtrim që do ta



ndryshonin rezultatin e zgjedhjeve 2020. Ajo i heq edhe referencat ndaj deklaratave të caktuara të Trumpit, përfshirë një pretendim që ai e kishte bërë në një konferencë për media në Shtëpinë e Bardhë dy ditë pas zgjedhjeve për një kosh të dyshimtë të mbushur me vota në

Detroit. Por, aktakuza e re përmban një referencë të tronditëse të ngritura nga Smith, se Trumpi mori pjesë në një skemë të orkestruar nga aleatët për rekrutimin e pjesëtarëve të rrejshëm zgjedhorë në terren në shtetet ku demokracia Joe Biden

kishte fituar, të cilët do të dëshmonin rrejshëm se Trumpi i kishte fituar ato shtete.

Gjithashtu aktakuza ruan edhe dyshimet se Trumpi i kishte bërë trysni nën-presidentit Mike Pence për ta hedhur poshtë ligjshmërinë e votave dhe se Trumpi dhe aleatët e tij e shfrytëzuan kaosin në Capitol më 6 janar, në përpjekje për ta shtyrë edhe më shumë certifikimin e fitores së Bidenit.

Trump është sërish kandidat republikan për president në zgjedhjet e 5 nëntorit, dhe këtë herë ai do të garojë kundër zëvendës-presidentes Kamala Harris, e cila, sipas sondazheve, ka një epërsi të vogël ndaj tij në nivel kombëtar.


Në maj, Trump u bë presidenti apo ish-presidenti i parë amerikan që dënohet për vepër penale.

Një gjykatë në Nju Jork e shpalli Trumpin fajtor për falsifikimin e regjistrave biznesore për të ndikuar jashtëligjshëm në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, përmes pagesave për heshtjen e një aktoreje të pornografisë, e cila tha se kishte kryer marrëdhënie seksuale me të.

Rrëzohet një helikopter i ushtrisë së Bosnjës, ekuipazhi shpëton

SARAJEVË, 28 GUSHT - Një helikopter i Forcave të Armatosura të Bosnje dhe Hercegovinës u rrëzua të mërkurën në zonën e liqenit Jabllanica, në jug të Bosnje dhe Hercegovinës, konfirmoi për Radion Evropë e Lirë Ministria e Punëve të Brendshme e Kantonit Hercegovinë-Neretva.

“Në helikopter ishin katër anëtarë të ekuipazhit. Sipas informacioneve fillestare, tre prej tyre nuk janë lënduar, ndërsa njëri ka kërkuar ndihmë



mjekësore”, tha zëdhënësi Ludeviti Mariq.

Sipas tij, shkaku i aksidentit nuk dihet ende, ndërsa hetimet në lidhje me të, do të rezultojnë me më shumë detaje.

Forcat e Armatosura të Bosnje dhe Hercegovinës kanë në dispozicion më shumë se 40 helikopterë, raporton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropë e Lirë. Midis tyre janë 35 helikopterë Mi-8, që janë prodhuar më shumë se 40 vjet më parë në Bashkimin e atëhershëm

Sovjetik.

Më herët është paralajmëruar se ata do të hiqen nga përdorimi, për shkak të vjetërisë dhe pamundësisë për t'i mirëmbajtur.

Në vitin 2021, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i dhuruan Bosnje dhe Hercegovinës katër helikopterë të rinj Bell, me vlerë rreth 35 milionë euro.

Njëri prej tyre u rrëzua dhe u dëmtua në prill të vitit 2022, gjatë një stërvitjeje.

Dy punëtorë të Delta-s vriten gjatë një kontrolli për mirëmbajtjen e avionit në aeroport

ATLANTA, 28 GUSHT - Dy punonjës të Delta Air Lines janë vrarë dhe një është plagosur rëndë pas një aksidenti në një objekt të mirëmbajtjes së linjës ajrore në Atlanta.

Punëtorët po servisnin një aeroplan Delta në timonin e linjës ajrore dhe dyqanin e frenave në Aeroportin Ndërkombëtar Hartsfield-Jackson Atlanta pak

pas orës 05:00 të së martës. Nuk dihet se si ka ndodhur ngjarja. Autoritetet mjekësore lokale i identifikuan të vdekurit si Mirko Marëeg, 58 vjeç dhe Luis Aldarondo, 37 vjeç. Emri i personit të plagosur nuk u bë i ditur.

Në një deklaratë, linja ajrore tha: “Familja Delta është e mjaft e trishtuar për humbjen e dy

anëtarëve të ekipit dhe plagosjen e një tjetri pas një incidenti këtë mëngjes në objektin e mirëmbajtjes së operacioneve teknike në Atlanta. Tani po punojmë me autoritetet lokale dhe po kryejmë një hetim të plotë për të përcaktuar se çfarë ka ndodhur”.

Delta tha se punëtori i plagosur po merrte kujdes mjekësor.



Paga minimale në Kosovë rritet në 350 euro

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e rregullt të mbajtur të mërkurën ka vendosur për rritjen e pagës minimale në 350 euro bruto. Me vendimin e ri të Qeverisë së kryeministrit Albin Kurti, shkalla e re e pagës minimale do të jetë 2 euro për orë pune të rregullt, apo 350 euro bruto në muaj për orar të plotë. “Kjo është rritja e dytë e pagës minimale brenda këtij mandati qeverisës”, ka thënë Kurti. E opozita ka theksuar se kjo rritje e pagës minimale është poshtërim dhe sipas tyre është dashur të jetë 450 euro



“natyrisht duke shënau rritje të përvitshme, në bazë të rritjes ekonomike e inflacionit dhe në këtë pagë minimale duhet të përfshihen të gjitha kategoritë e pensioneve. Vendet e rajonit, qysh moti e kanë kaluar pragun e pagës minimale prej 500 eurosh, ndërsa ky kryeministër, jo vetëm që është vonuar me rritje pagash për katër vjet, por edhe sot pagën minimale e konsideron ndihmë sociale”, ka thënë Haradinaj.

PDK-ja: Me këto çmime të rritura nuk dihet kujt do t'ia ndryshoj jetën paga 350 euro

Rritja e pagës minimale në 350 euro bruto, vendim ky i cili është marrë në mbledhjen e 218-të të Qeverisë së Kosovës të mërkurën do të kishte relevancë nëse i njëjti vendim do të merrej 4 vjet më parë në fillim të mandatit të ekzekutivit. Kështu të paktën ka vlerësuar Koordinatori për Financa në kuadër të Kabinetit për Qeverisje të Mirë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Arben Mustafa, në vlerësimin e të cilit kjo rritje nuk do ta ndryshojë jetën e qytetarëve për shkak të çmimeve të rritura. “Ky lajm do të kishte zënë më tepër vend para katër viteve kur e kanë filluar mandatin, por tani në këto kushte të çmimeve të rritura, nuk dihet kujt do t'ia ndryshoj jetën ky vendim”, ka shkruar ai në “Facebook”.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 GUSHT - Qeveria e Kosovës mori vendim të mërkurën ta rrisë pagën minimale në vend në 350 euro për punëtorët e të gjitha moshave.

Kjo rritje u bë vetëm disa ditë pasi hyri në fuqi Ligji për pagën minimale, i cili parashihte një rritje të pagës minimale në 264 euro bruto për të gjithë të punësuarit në sektorin publik e privat.

Por, me vendimin e ri të Qeverisë së kryeministrit Albin Kurti, shkalla e re e pagës minimale do të jetë 2 euro për orë pune të rregullt, apo 350 euro bruto në muaj për orar të plotë. “Me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagën minimale, më në fund u hap rruga që edhe zyrtarisht të rritet paga minimale pas një pritjeje prej 13 vjetësh. Ndërkaq sot do të shqyrtojmë propozimin e Ministrisë së Financave, Punës

dhe Transfereve që niveli i ri i pagës minimale të jetë 2 euro për orë pune të rregullt, apo 350 euro bruto në muaj për punë me orar të plotë. Paga minimale do të jetë e liru nga tatimi. Kjo është rritja e dytë e pagës minimale brenda këtij mandati qeverisës”, ka thënë Kurti.

Paga e re minimale do t'i prekë rreth 150.000 të punësuar, të cilët punojnë me paga më të ulëta se 350 euro, kryesisht në sektorin privat, sipas Kurtit dhe ministrit të Financave të Kosovës, Hekuran Murati.

“Ky veprim është veçse edhe një hap tjetër në kuadër të masave të shumta që kemi ndërmarrë si Qeveri për ta përmirësuar mirëqenien e qytetarëve”, tha Kurti.

Ndërkaq, Murati tha se vendimi për rritjen e pagës minimale do të hyjë në fuqi më 1 tetor. “Do të sigurohem që ligji dhe vendimi për rritjen e pagës minimale do të zbatohet”, deklaroi Murati.

Vendimi i ri për pagën minimale i

jep fund edhe diskriminimit të punëtorëve në bazë të moshës. Deri në fuqizimin e Ligjit të ri, paga minimale në Kosovë ishte 130 euro për punëtorët nën 35 vjeç dhe 170 euro për punëtorët deri në 65 vjeç.

Kosova, deri më tani e ka pasur pagën minimale më të ulët në Evropë, 170 euro, ndërsa Luksemburgu më të lartën, 2.571 euro.

Haradinaj: Paga minimale 350 euro është poshtërim

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar pas ngritjes së pagës minimale nga qeveria

në 350 euro. Sipas Haradinajt, kjo pagë minimale është poshtërim. “Ata që s'kanë preokupim tjetër përpos si të mbeten në pushtet, gjithmonë në prag të zgjedhjeve, dalin me mashtrimet e radhës për rritje pagash, ulje çmimesh, vende pune e lloj-lloj mrekullirash të tjera. Në kuadër të një fushate për zgjedhje, Qeveria e VV-së, sot paska marrë vendim që të rritet paga minimale në 350 euro. Premtimi për këtë pagë minimale është poshtërim”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Ai ka thënë se paga minimale qysh sot duhet të jetë 450 euro, e që në ditën e parë të qeverisë së re, më së paku 500 euro.

Specialja rrëzon kërkesën e “Topit” për ta ndarë procesin gjyqësor nga Januzi dhe Bahtijari



HAGË, 28 GUSHT - Gjykatësja e procedurës paraprake në Gjykatën Speciale ka hedhur poshtë kërkesën e Haxhi Shalës, i njohur si komandanti “Topi”, për veçimin e çështjes kundër tij nga çështja kundër Januzit dhe Bahtijarit.

Po ashtu, në çështjen kundër Sabit Januzit dhe të tjerëve gjykatësja ka hedhur poshtë kërkesën e mbrojtjes së Ismet Bahtijarit për zgjatje të afatit për dorëzimin e dosjes paraprake të përditësuar të saj. Në njoftimin e lëshuar nga Specialja është thënë gjykatësja Marjorie Masselot, ka konstatuar se mbrojtja nuk ka demonstruar

se zgjatja e afatit është e përligjur dhe rikujtoi të gjitha ekipet e mbrojtjes se duhet të dorëzojnë dosjet e tyre paraprake deri më 2 shtator, sipas udhëzimeve në vendimin e saj të mëparshëm. “Në një vendim tjetër, gjykatësja Masselot, gjithashtu hodhi poshtë kërkesën e Haxhi Shalës për veçimin e çështjes kundër tij nga çështja kundër Januzit dhe Bahtijarit dhe që të ketë një gjykim të veçantë. Në marrjen e vendimit të saj, gjykatësja vuri në dukje se gjykimet e veçanta do të shtonin në mënyrë të pashmangshme kohën dhe burimet e gjykatës dhe do të rrezikonin të drejtat e të

akuzuarit për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme”, ka njoftuar Gjykat Speciale. Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari janë arrestuar në Kosovë më 5 tetor 2023 dhe janë transferuar në objektin e paraburgimit Hagë më 6 tetor 2023, në bazë të aktakuzës së konfirmuar. Në aktakuzën e konfirmuar është thënë se Haxhi Shala akuzohet për “(i) frikësim dhe (ii) tentativë me anë të kërcënimit të rëndë për të penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, individualisht dhe me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi”.

Azemi: Punëtorët teknik dhe ata fizik të shkollave në Prishtinë nga 3 shtatori fillojnë grevën

PRISHTINË, 28 GUSHT - Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka njoftuar se më 3 shtator do të fillojnë grevën punëtorë teknik dhe punëtorët e sigurimit fizik të disa shkollave në Prishtinë. Ai ka bërë me dije se grevës do t'i bashkohen edhe punëtorët e sigurimit fizik

të QKUK-së. Azemi ka treguar se arsyeja e kësaj greve është pagat e ulëta. “Me kërkesën e punëtorëve teknikë dhe atyre të sigurimit fizik të shkollave: ‘Dardania’, ‘Pjetër Bogdani’, e Muzikës, ‘Naim Frashëri’, ‘Shkolla e Gjellbër’, ‘Mehmet Xhevor’, ‘Hoxhë Kadri Prishtina’, ‘Avdyl Frashëri’,

‘Asim Vokshi’, ‘Gjergj Fishta’ të komunës së Prishtinës, të gjitha QMF-të në Prishtinë dhe punëtorët e sigurimit fizik të QKUK-së më 3 shtator do të fillojnë grevën e tyre pasi që pagat e tyre ka gjasa mos të implementohen me rritje nga 1 shtatori”, ka shkruar Azemi në “Facebook”.





Kthimi i Trumpit apo fitorja e Harrisit? Ballkanin mund ta presin ndryshime, thotë Joseph

WASHINGTON, 28 GUSHT - Edward P. Joseph, ligjërues në Universitetin Johns Hopkins në ShBA, flet në një intervistë për Radion Evropa e Lirë për ndikimin që mund ta ketë rezultati i zgjedhjeve në Shtetet e Bashkuara në Ballkanin Perëndimor.

Joseph thotë se rikthimi i mundshëm i Donald Trumpit në presidencë, mund të çojë në ndryshime drastike në politikën e jashtme të ShBA-së. Në atë rast, ai nuk e përjashton mundësinë e një marrëveshjeje me Rusinë për Ukrainën, që, siç thotë, do të ndikonte drejtpërdrejt në Ballkan.

Për fitoren e mundshme të Kamala Harrisit nuk është i sigurt se çfarë do të sillte, por, sipas tij, do të ishte e rëndësishme që Harris ta adresonte "paradoksin ballkanik". "Pas pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022, Perëndimi është më i fuqishëm dhe më i bashkuar dhe Rusia është më e dobët dhe më e izoluar, ndërsa situata në Ballkan është përkeqësuar. Ky është paradoksi ballkanik", thotë Joseph.

Ai flet edhe për vizitën e shefit të CIA-s, William Burns, javën e kaluar në disa vende të Ballkanit.

Fushata zgjedhore në ShBA po merr hov, ndërkohë që gara mes dy kandidatëve është tejet e ngushtë. Ka shumë pasiguri - sondazhet nxjerrin në epërsi herë Harrisin, herë Trumpin. Sa ndihet kjo

pasiguri në rajonin e Ballkanit Perëndimor?

Edward P. Joseph: Fakti që gara është e ngushtë, nuk e ndikon Ballkanin, por e ndikon perspektiva e rikthimit të Donald Trumpit në presidencë. Cilido kandidat tjetër republikan të ishte - qoftë të kaluarit si Mitt Romney apo George Bush, apo të mëvonshmit si Marco Rubio apo Nikki Haley - ju nuk do të më pyesnit nëse kjo zgjedhje do ta ndikonte Ballkanin. Do të ishte me interes për Ballkanin, por nuk do të ndikonte në Ballkan. Ajo që e prek rajonin, është perspektiva e rikthimit të Donald Trumpit dhe qasja thelbësisht tjetër ndaj politikës së jashtme dhe ndaj rolit të Amerikës në botë. Kjo, padyshim, do të ndikonte në Ballkan dhe në pjesën tjetër të botës. Sepse, [në atë rast] ekziston perspektiva e një aleance krejt tjetër - e një aleance me autokratë - që do të vinte në pikëpyetje vazhdimin e qasjes së njëjtë ndaj [presidentit rus, Vladimir] Putin dhe ndaj Ukrainës. Njëjtë do të ishte edhe me Ballkanin: do të vazhdohej apo do të lihej mënjënjë për kushtimi ndaj disa parimeve në Ballkan.

Konkretisht, si do ta ndikonte Ballkanin rikthimi i mundshëm i Trumpit?

Edward P. Joseph: Një ndër çështjet kryesore me efekt në Ballkan, është Ukraina, lufta në

Ukrainë. Ai [Trump] mund të përpiqet të arrijë marrëveshje me Rusinë për Ukrainën dhe ta shtyjë Ukrainën drejt një zgjidhjeje territoriale. Nëse e bën këtë, duke treguar një lloj marrëdhënieje miqësore me Putinin, kjo ndikon menjëherë në Ballkan. Sepse, aleanca me autokratë si Putini nënkupton qasje më të butë ndaj [presidentit të Serbisë, Aleksandar] Vuçiq. Për mendimin tim, edhe administrata e Bidenit ka qenë tejet e butë ndaj tij. Duhet theksuar se Harris, kur e ka pranuar nominimin e Partisë Demokratike në Çikago, ka thënë se nuk do të miqësohet me autokratë.

Në politikën e jashtme, amerikanët kanë çështje të mëdha në agjendë - ju e përmendet luftën në Ukrainë, pastaj është lufta në Gazë. Në krejt këtë vorbull ngjarjesh, ata kanë kthyer vëmendjen edhe kah Ballkani - gjë të cilën mund të themi se e dëshmon edhe vizita e shefit të CIA-s, javën e kaluar...

Edward P. Joseph: Ajo që mund të nxjerrim nga kjo vizitë, është shqetësimi i vazhdueshëm i administratës Biden për Ballkanin. Duhet kujtuar se në fillim të kësaj administrate, ka pasur zyrtarë që e kanë thënë publikisht në seanca dëgjimore të Kongresit se nuk ka ndonjë arsye për t'u shqetësuar për konflikte

në Ballkan. Tani, në gusht të vitit 2024, keni drejtorin e CIA-s, i cili është i përfshirë në negociatat jashtëzakonisht komplekse për armëpushimin [në Gazë], që shkon në së paku tri kryeqytete të Ballkanit. Arsyeja që ka shkuar nuk ka të bëjë me mbajtjen e interesimit në rajon, por ka të bëjë me brengat dhe shqetësimet për të. Dhe kjo dallon nga ajo që kemi dëgjuar në fillim të administratës Biden.

A po përpiqet ShBA-ja të përfundojë ndonjë gjë në Ballkan përpara zgjedhjeve?

Edward P. Joseph: Unë nuk e shoh kështu. Do të ishte mirë sikur të ishte dhe sikur të kishte ndonjë iniciativë, por unë nuk e shoh vizitën e Burnsit në këtë kontekst. Ajo ishte një vizitë për frenim, për t'i paralajmëruar aktorët si [presidenti i Republikës Serpska, Millorad] Dodik dhe të tjerët që do të mund të merrnin hapa destabilizues. Dhe, Burns është një përçues shumë i mirë i mesazheve.

Dërgimi i tij ka qenë një veprim i mirë, por unë nuk e shoh atë si pjesë të ndonjë misioni të shpëtimit, apo të ndonjë zgjidhjeje. Nëse ka nisma të fshehta, do të ishte mirë, por nuk i shoh ato si qëllim të vizitës së tij. Për mua, ajo ishte një paralajmërim i ashpër për ata që do t'i përkeqësonin gjërat, dhe jo për t'i përmirësuar

gjërat ose për të mbyllur çështje të hapura.

Për çfarë mendoni se mund të ketë diskutuar Burns në Kosovë?

Edward P. Joseph: Shikojeni fotografinë që është publikuar. Keni parë Burns-in të ulur pranë kryeministrit [të Kosovës, Albin] Kurti. Në të djathtë të Burns-it ka qenë ambasadori [i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeffrey] Hovenier, duke marrë shënime.

Unë mendoj se ajo që Burns i ka thënë Kurtit, është mesazhi që ka dhënë edhe ambasadori Hovenier për të mos ndërmarrë veprime të njëanshme dhe për të mos destabilizuar rajonin. Si drejtor i CIA-s, Burns mund të ketë kërkuar edhe rritjen e ndërgjegjësimit për aktivitetet dhe interesimin e Rusisë në rajon. Në anën tjetër, Kurti mund t'i ketë bërë presion Burns-it për pozicionin e ShBA-së ndaj Vuçiqit dhe për rastin e sulmit në Banjskë. Sepse, Burns është personi ideal për t'u pyetur në lidhje me Banjskën, çfarë ka ditur Vuçiq dhe cili ka qenë roli i tij. Ky mund të ketë qenë një moment ideal për ta ngritur këtë çështje. Nuk e di nëse Kurti e ka bërë këtë, por shefi i CIA-s është personi ideal.

Unë besoj që edhe në Beograd, Burns ka pasur një takim të hapur me Vuçiqin, ku me terma të qartë ia ka bërë të ditur se ne e dimë se çfarë ka ndodhur në Banjskë, e

25 profesorë universitarë i kërkojnë Kurtit e Haxhiut t'i heqin kufizimet për mbrojtjen e krerëve të UÇK-së në Hagë



PRISHTINË, 28 GUSHT - 25 profesorë universitarë kanë thënë se janë të shqetësuar lidhur me kufizimet financiare të vendosura ndaj mbrojtjes juridike të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe personave të tjerë të akuzuar në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara në Hagë.

Profesorët universitarë, përmes një letre që i kanë dërguar kryeministrit Albin Kurti dhe ministres Albulena Haxhiu, theksojnë se "vendimi për të zvogëluar shpenzimet për mbrojtjen juridike cenon të drejtën për një mbrojtje efektive dhe barazi në proces, duke vënë në rrezik integritetin dhe legjitimitetin e kauzës së drejtë të luftës së UÇK-së".

Në letrën e tyre, 25 profesorët

universitarë kërkojnë rishikimin urgjent të udhëzimit administrativ që kufizon mbështetjen financiare, me qëllim që të sigurohet respektimi i të drejtave të të akuzuarve dhe të mbrohet e drejta historike dhe ligjore e Kosovës.

Nënshkruet të kësaj letre, që i është dorëzuar në muajin prill kryeministrit Kurti dhe ministres Haxhiu janë profesorët si Enver Hasani, Hakif Bajrami, Muhamet Mustafa, Isa Qosja, Shefkije Islamaj, Adem Rusinovci, Shkumbin Istrefi, Ismet Sijarina, Luan Jaha dhe shumë të tjerë.

Ata në letrën e tyre konsiderojnë se "kufizimi i shpenzimeve financiare për ekipet mbrojtëse të ish-krerëve të UÇK-së dhe/ose të personave të akuzuar për krimet e supozuara, siç

përcaktohen shprehimisht në Ligjin Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, përbën vendim të pabazë, të paarsyeshëm dhe

joproporcional, i cili njëkohësisht paraqet edhe kufizim të mundësisë dhe të aftësisë për mbrojtje të kauzës së drejtë të luftës heroike të UÇK-së".

Duke qenë të bindur në pastërtinë e luftës së UÇK-së dhe duke marrë në konsideratë rreziqet e rikonfirmimit të integritetit të saj, 25 profesorët universitarë kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës që urgjentisht t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme për rishikimin e këtij udhëzimi administrativ, në mënyrë që të mos kufizohet dhe pengohet arritja e qëllimit.

Per: - Z. Albin Kurti, Kryeminister
Qeveria e Republikës së Kosovës
- Znj. Albulena Haxhiu, Ministre
Ministria e Drejtësisë

Nga: Profesorët universitarë, nënshkruet të kërkesës

Lenda: Kërkesë për rishqyrtimin e aktit qeveritar për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara në Hagë

I nderuar kryeministër z. Kurti,

E nderuar ministre znj. Haxhiu,

Duke shprehur konsideratë për ju dhe funksionet institucionale që i ushtroni, përmes kësaj letre, ju vëme në dijeni se jemi duke ndjekur me shqetësim njoftimet e ekipeve mbrojtëse të ish-krerëve të UÇK-së për largimin e avokateve mbrojtës si rezultat i vendimit qeveritar për kufizimin e pagesave, respektivisht zvogëlimin e shpenzimeve për qëllime të mbrojtjes juridike të tyre në procesin gjyqësor pranë Dhomave të Specializuara në Hagë.

Siç e dini, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 3 gusht 2015, krahas miratimit të Amendamentit nr. 24 të Kushtetutës, ka miratuar Ligjin Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe Ligjin Nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencialë në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, e cila ka përcaktuar qartë të drejtën për mbrojtje juridike dhe

Emri dhe Mbiemri:

1. Hakif Bajrami
2. Enver Hasani
3. Fuqajllahi Husari
4. Muhamet Mustafa
5. Ismet Sijarina
6. Berim Perlezi
7. Bedri Dragusha
8. HALIL DEMOLLI
9. SABIT SELA
10. Shefkije Islamaj
11. ADEM RUSINOVCI
12. FATON MEROVCI
13. Zaim Gashi
14. MEGHMET JEREMI
15. BEULI BALLAZHI

Nënshkrimi:

Handwritten signatures of the 15 professors listed on the left, including Hakif Bajrami, Enver Hasani, Fuqajllahi Husari, Muhamet Mustafa, Ismet Sijarina, Berim Perlezi, Bedri Dragusha, Halil Demolli, Sabit Sela, Shefkije Islamaj, Adem Rusinovci, Faton Merovci, Zaim Gashi, Meghmet Jeremi, and Beuli Ballazhi.

dimë se cili ka qenë roli juaj president Vuçiq dhe i dimë aktivitetet e figurave të tjera në Qeverinë tuaj. Pra, e dimë se çfarë ka bërë Qeveria juaj për të destabilizuar situatën dhe ne presim që t'i ndaloni ato veprime. Unë shpresoj që Burns ta ketë thënë këtë në Beograd, por, sigurisht, ato janë takime konfidenciale dhe nuk e di.

A mendoni se kjo vizitë do të ndryshojë ndonjë gjë në raportet Kosovë-Serbi?

Edward P. Joseph: Ndoshta jo në mënyrë drastike menjëherë, por ka potencial. Sepse, nëse Kurti dhe Vuçiq e kuptojnë qartazi se Shtetet e Bashkuara e dinë - dhe normalisht e dinë sepse Burns është shef i inteligjencës - se cilat veprime e destabilizojnë situatën dhe se ShBA-ja nuk do t'i tolerojë

ato, atëherë një gjë e tillë mund t'i largojë disa tundime nga tryeza dhe ndoshta ta ripërqendrojë vëmendjen te bashkëpunimi. Mendoj kështu potencialisht, por nuk shoh diçka të menjëhershme apo dramatike.

Në Bosnje, njëri entitet udhëhiqet nga njerëz që janë në listën e zezë të SHBA-së, por edhe në Qeverinë e Serbisë ka persona të tillë. A mund të arrihet diçka me këta njerëz?

Edward P. Joseph: Unë shpresoj. Kemi indikacione se vizita e Burns-it i ka pasur disa efekte, sepse Dodik ka deklaruar më pas se qëllim i Republikës Sërpska nuk ka qenë kurrë ndarja nga pjesa tjetër e Bosnje e Hercegovinës. Kjo më sugjeron të mendoj se mesazhi i Burns-it në Banja Llukë ka pasur ndikim. Në Beograd, nuk jam i sigurt se

është marrë mesazhi, sepse administrata Biden ka qasje konfliktuale ndaj Beogradit, ndryshe prej Banja Llukës. Zyrtarë të caktuar amerikanë e lavdërojnë vazhdimisht Qeverinë e Serbisë për atë që bën, për shembull, në Ukrainë.

Folët më herët për ndikimin e fitores së mundshme të Trumpit në Ballkan. Dua t'ju pyes për fitoren e mundshme të Harris-it. Si do ta ndikonte ajo Ballkanin dhe problemin mes Kosovës dhe Serbisë konkretisht?

Edward P. Joseph: Nuk e di përgjigjen në këtë pyetje dhe nuk e di nëse do të jetë një vazhdimësi e qasjes së Biden-it, e cila në disa aspekte ka qenë vazhdimësi e qasjes së Trump-it. Trump ka shtyrë përpara mini-Schengenin, Biden ka shtyrë përpara

Ballkanin e Hapur. Situata në Ballkan është përkeqësuar dhe nëse Harris do t'i marrë parasysh vështirësitë që Biden ka hasur në Ballkan që nga fillimi i luftës në Ukrainë dhe do të provojë diçka ndryshe, nuk e di.

Mendoni se ShBA-ja duhet të angazhohet më shumë në Ballkan?

Edward P. Joseph: Nëse më pyesni se çfarë do të duhej të bënte Harris... ajo duhet t'i shqyrtojë me kujdes vështirësitë që ka pasur administrata Biden dhe të përballet me - siç e kam quajtur unë në shkrimet e mia - paradoksin ballkanik. Ajo duhet të përballet me paradoksin ballkanik.

E, çka është paradoksi ballkanik? Pas pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022, Perëndimi

është më i fuqishëm dhe më i bashkuar dhe Rusia është më e dobët dhe më e izoluar, ndërsa situata në Ballkan është përkeqësuar. Ky është paradoksi ballkanik. Pse situata në Ballkan është përkeqësuar kur Perëndimi është më i fortë dhe më i bashkuar dhe Rusia është më e dobët dhe më e izoluar? Pse raportet mes Kosovës dhe Serbisë janë edhe më të përkeqësuar? Pse situata e brendshme në Serbi është përkeqësuar? Pse janë përkeqësuar raportet mes Serbisë dhe Malit të Zi? Pse janë përkeqësuar raportet mes Serbisë dhe Kroacisë?... Kamala Harris dhe këshilltarët e saj do të duhej të përballeshin me paradoksin ballkanik. Dhe, ndryshe nga zyrtarë të lartë të administratës Biden, ata duhet të ndalojnë së pretenduari se ai nuk ekziston.

Kurti: Po bëjmë të gjitha konsultimet e nevojshme për hapjen e urës

PRISHTINË, 28 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se Qeveria e tij është duke i vazhduar konsultimet dhe diskutimet me aleatët në lidhje me hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër, e cila ndan Mitrovicën në pjesën e jugut, të banuar me shumicë shqiptare, dhe atë të veriut, e banuar me shumicë serbe.

Duke folur në një mbledhje të Qeverisë së tij të mërkurën, Kurti njoftoi se Kosovën do ta vizitojnë dy ministra të Jashtëm të dy vendeve anëtare të NATO-s javën e ardhshme, ndërsa të enjten edhe ndihmëssekretari i Përgjithshëm për Operacione i NATO-s, Thomas Goffus.

Kurti nuk tregoi se ministrat e cilave vende anëtare të aleancës ushtarake do ta vizitojnë Prishtinën.

Ai paralajmëroi se sot Kosovën e viziton një delegacion danez i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. "Në të gjitha

këto takime natyrisht diskutohet edhe çështja e hapjes së urës qendrore mbi lumin Ibër në Mitrovicë, për të cilën jemi duke i bërë të gjitha konsultimet e nevojshme, si dhe punët tona të shtëpisë, si për shembull trajtimi i draftit preliminar për qëndrueshmërinë fizike të urës, tekta presim raportin final, e deri te përgatitjet për rregullimin e pamjes dhe pastrimin e mjedisit rrotull saj", tha Kurti.

Një ditë më parë, Kurti u takua me shefin e Komandës së Forcave të Përbashkëta të NATO-s në Napoli, admiral Stuart Munsch, me të cilin ka biseduar për sigurinë në vend.

Qeveria e Kosovës njoftoi në fillim të gushtit synimet e saj për ta hapur urën mbi lumin Ibër edhe për qarkullim të automjeteve, pasi ajo është e hapur vetëm për këmbësorë.

Vizitat e zyrtarëve të NATO-së



dhe të tjerëve në Kosovë po zhvillohen në kohën kur Shtetet e Bashkuara, BE-ja, por edhe vetë misioni i aleancës ushtarake, KFOR, e kanë kundërshtuar synimin e Qeverisë së Kosovës për hapjen e

urës në këtë kohë.

KFOR-i, njëllon sikur BE-ja, ka kërkuar që kjo çështje të trajtohet në dialogun e Brukselit. Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, po ashtu, ka paralajmëruar disa herë se nuk

do të hezitojë të veprojë për t'iu përgjigjur zhvillimeve të lidhura me sigurinë.

Ushtarët italianë të KFOR-it patrollojnë në urën mbi lumin Ibër, ndërsa afër ndodhen edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Vulinit nuk i lejohet të fluturojë mbi Bosnje dhe Hercegovinë

Prishtinë, 28 gusht- Autoritetet në Bosnje dhe Hercegovinë nuk i dhanë leje zëvendëskryeministrit të Serbisë, Aleksandar Vulin, për të fluturuar me helikopter në Pale, afër Sarajevës, njoftoi Qeveria e Serbisë.

Vulin duhej të merrte pjesë në një festë të kësaj komune, të njohur si Vellika Gospojina, dhe të vendoste lule në Sheshin e Republikës Sërpska për luftëtarët serbë që humbën jetën në luftën e viteve 1990. "Edhe pse kabineti i zëvendëskryeministrit të Serbisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ambasada e Serbisë i kanë dorëzuar në mënyrë të rregullt dhe me kohë të gjitha informatat e nevojshme dhe dokumentet mbështetëse, e madje kanë deklaruar qëllimin e vizitës, autoritetet në Federatë,



me heshtjen dhe mospërgjigjen e tyre, nuk e kanë dhënë pëlqimin për fluturim", thuhet në komunikatën që transmeton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropa e Lirë.

Në njoftim thuhet, gjithashtu, se Ambasada e Serbisë i ka respektuar të gjitha procedurat e

kërkuara, por, pavarësisht kësaj, autoritetet në Bosnje dhe Hercegovinë nuk i janë përgjigjur kërkesës.

Deri në publikimin e këtij lajmi, autoritetet në Bosnje dhe Hercegovinë nuk u deklaruan në lidhje me këtë rast.

Vulin, megjithatë, arriti në

ceremoninë në Pale, por me veturë zyrtare, raporton agjencia serbe e lajmeve, Beta.

Vulinit nuk iu dha leje për të fluturuar në Bosnje dhe Hercegovinë as më 5 gusht, kur ishte dashur të merrte pjesë në hapjen e një ekspozite kushtuar vuajtjeve të serbëve në Luftën e Dytë Botërore në Prebillovci - një fshat në jug të Bosnjës.

Siç shpjegoi në atë kohë ministri i Punëve të Jashtme i Bosnje dhe Hercegovinës, Ellmedin Konaković, Vulinit nuk i është dhënë leja për të arritur në Bosnje me helikopter, pasi kërkesa ka mbërritur shumë vonë dhe se ai nuk ka dashur t'i shkelte procedurat, meqë është person, i cili "e minon integritetin territorial dhe sovranitetin e Bosnje dhe Hercegovinës çdo ditë".

Pas kësaj ngjarjeje, Serbia i dërgoi një notë proteste Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bosnje dhe Hercegovinës, duke vlerësuar se një vendim i tillë "nuk është në frymën e marrëdhënieve të mira fqinjësore".

Vulin arriti të manifestimin në Prebillovci të nesërmen.

R retorika e Beogradit zyrtar dhe Sarajevës është ashpërsuar muajt e fundit.

Një nga arsyt ishte lobomi i autoriteteve në Beograd kundër miratimit të një rezolute të Kombeve të Bashkuara për gjenocidin në Srebrenicë.

Më 23 maj, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Rezolutën që e shpalli 11 korrikun Ditë Ndërkombëtare të Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë.

Zgjatet procesi i regjistrimit të diasporës

PRISHTINË, 28 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të mërkurën për zgjatjen e afatit të procesit të regjistrimit të diasporës deri në fund të këtij viti.

Kjo është hera e dytë që zgjatet procesi i regjistrimit të diasporës, i cili bëhet online përmes portalit eDiaspora, me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Në maj, procesi ishte zgjatur deri më 31 gusht, por ai tani do të vazhdojë deri më 31

dhjetor 2024. Ministria e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, tha se intensiteti i regjistrimit të diasporës është rritur ditëve të fundit dhe për këtë ajo kërkoi në mbledhjen e Qeverisë të mërkurën që anëtarët e kabinetit të votojnë për zgjatjen e procesit deri më 31 dhjetor. "Të dhënat që duhet të dalin nga regjistrimi i mërgatës do të na shërbejnë edhe institucioneve të vendit, por edhe vetë mërgatës për një

organizim më të mirë të nevojave dhe potencialit. Ndërkohë, gjatë ditëve të fundit kemi pasur një dinamikë me rreth 3.000 regjistrime në ditë, që do të thotë se do të përpiqemi që këtë dinamikë mos ta ndalim përmes përfundimit të afatit", tha ajo.

Në korrik, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) tha se deri në atë kohë ishin regjistruar rreth 600.000 pjesëtarë të diasporës.

Regjistrimi i popullsisë,



ekonomive familjare dhe banesave, u zhvillua në të gjitha komunat e Kosovës nga 5 prilli deri më 24 maj.

Sipas të dhënave paraprake të ASK-së për regjistrimin e popullsisë Kosova i ka 1.586.659 banorë rezidentë.

Kërkohet nga presidentja Osmani dhënia e autorizimit për nënshkrimin e tri marrëveshjeve me Suedinë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 GUSHT - Në mbledhjen e së mërkurës të Qeverisë së Kosovës, zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli, propozoi për shqyrtim dhe miratim propozim vendimet për të kërkuar nga presidentja dhënie e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes për Ndihmë Juridike të Ndërsjellët në Çështje Penale, asaj për ekstradim si dhe marrëveshjes për Transferimin e Personave të Dënuar në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Suedisë.

Marrëveshja e parë, përkatësisht ajo për Ndihmë Juridike të Ndërsjellët në Çështjet Penale synon krijimin e një baze ligjore dypalëshe që do të thellojë bashkëpunimin dhe do të harmonizojë procedurat për ndihmë juridike mes dy vendeve, duke garantuar një bashkëpunim më efektiv.

Në anën tjetër, Marrëveshja për Ekstradim përmban rregullime të hollësishme për procedurat që do të ndiqen nga momenti i parashtrimit të kërkesës për

ekstradim deri në dorëzimin e personit të ekstraduar, në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe pasqyron praktikën më të mira evropiane për trajtimin e kërkesave për ekstradim.

Ndërsa, marrëveshja për Transferimin e Personave të Dënuar me Qeverinë e Mbretërisë së Suedisë, mes tjerash, ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e drejtësisë dhe rehabilitimin social të personave të dënuar, duke lejuar transferimin e tyre për ekzekutimin e dënimeve në shtetin e vendbanimit të përhershëm.

Marrëveshjet e tilla, janë edhe një hap tutje më avancimin dhe thellimin e partneritetit dhe bashkëpunimit me shtete të ndryshme të Evropës dhe me gjerë. Qeveria e Republikës së Kosovës beson se këto vendime janë hapa të rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar dhe garantimin e drejtësisë në përputhje me standardet më të larta. Pas marrjes së autorizimit nga Presidentja, Marrëveshjet do të nënshkruhen



dhe do të hyjnë në fuqi sa më shpejt të jetë e mundur.

Gjatë muajit shtator (përkatësisht më 25 shtator), pritet nënshkrimi i marrëveshjeve të tilla ndërmjet të dyja vendeve.

Në këtë mbledhje të Qeverisë, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës ka paraqitur për shqyrtim dhe aprovim propozim-

vendimin për emërimin e Komisionit ad-hoc të Pranimit për Kategorinë e Lartë Drejtuese: Drejtor (Ekzekutiv) i Përgjithshëm në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.

Procedurat për këtë emërim janë zhvilluar në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren nr. 15/2023 për

Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.

Kjo iniciativë synon përzgjedhjen e një drejtori ekzekutiv që do të udhëheqë Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas me profesionalizëm dhe përkushtim të lartë.

Qeveria miraton Projektligjin për Sigurimin Shëndetësor

PRISHTINË, 28 GUSHT - Qeveria e Kosovës e miratoi të mërkurën Projektligjin për Sigurimin e detyrueshëm Shëndetësor.

Me asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, anëtarët e kabinetit e miratuan projektligjin, i cili tani duhet të dërgohet në Kuvend për aprovim.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se kjo nismë është paraprirë nga një proces i detyruar planifikimi, analizimi dhe diskutimi, dhe se "ky është moment vendimtar për shtetin tonë". "Ky projektligj është hapi themelor drejt krijimit të sigurimeve shëndetësore në



vendin tonë. Ky proces është i pakthyeshëm dhe si të tillë e nisim sot, këtu, në këtë mbledhje. Me këtë nismë themelohet fondi i sigurimit

të detyrueshëm shëndetësor i Republikës së Kosovës", tha Vitia. Zbatimi i këtij ligji do të jetë "një ndër sfidat kryesore e Qeverisë

sonë", tha Vitia.

Buxheti për sistemin e përgjithshëm shëndetësor për vitin 2024 kap vlerën e 345 milionë eurove.

Sipas projektligjit, fondi i sigurimeve do të mbështetet edhe nga kontributet e punëtorëve. "Këto kontribute do të jenë një nga burimet e rëndësishme të financimit të shëndetësisë në të ardhmen e afërt. Buxhetit që ndahet për shëndetësinë, do t'i shtohen edhe kontributet e secilit prej nesh nga të hyrat personale", theksoi ai.

Kosova nuk ka sigurime shëndetësore, ndonëse në vitin

2007 ishte miratuar ligji për këtë çështje, por asnjëherë nuk hyri në fuqi, pasi shefi i atëhershëm i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë nuk e nënshkroi.

Pas pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, ishin vetë qeveritë e Kosovës ato që e tërhoqën ligjin, për shkak të implikimeve buxhetore.

Kuvendi i Kosovës arriti ta miratonte Ligjin e ri për sigurime shëndetësore në vitin 2014, mirëpo as ai nuk u zbatua.

Zbatimit të tij u tha se do t'i paraprinte një periudhë prej gjashtë muajsh për mbledhjen e fondeve, e cila do të niste nga 1 korriku i vitit 2017.

Hoxhaj kritikon Qeverinë Kurti: Nuk ka siguruar asnjë njohje dhe asnjë anëtarësim të vetëm

PRISHTINË, 28 GUSHT - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, aktualisht nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka reaguar përmes një shkrimi në lidhje me politikën e jashtme të Kosovës nën qeverisjen e kryeministrit Albin Kurti.

Hoxhaj ka shkruar në "Facebook" se gjatë mandatit gati katërvjeçar, nuk është siguruar asnjë njohje.

"Çfarëdo që nuk arrihet gjatë tronditjes nga disfata, është gjithnjë e më e vështirë të arrihet më vonë! Disfata e politikës së jashtme të Kosovës është e matshme sepse për katër vite të një mandati të plotë nuk ka siguruar asnjë njohje dhe asnjë anëtarësim të vetëm! Sot po e shoh ministrin e jashtëm serb në vizitë në Tonga, shtet që e ka njohur

Kosovën gjatë mandatit tim, por, çka më brengos është që ai gjatë tërë verës e deri më sot, ka vizituar shumë shtete që e kanë njohur Kosovën nga Azia, Afrika dhe Amerika Latine dhe fatkeqsisht, do shihen efektet e vizitës së tij! Opinioni publik nuk e di se ku është dhe çfarë bënë Ministria e Jashtme e Kosovës?", ka shkruar Hoxhaj.



Trepça shpall gjendje të jashtëzakonshme

PRISHTINË, 28 GUSHT - Menaxhmenti i ndërmarrjes publike, Trepça, ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme dhe ka vendosur që të pezullojë përkohësisht pushimet vjetore të punëtorëve.

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme, sipas vendimit të siguruar nga Radio Evropa e Lirë, vjen me qëllim të "realizimit të planit të biznesit për sasinë e koncentratit të humber gjatë ditëve të grevës". Ndërkaq, pushimet vjetore janë pezulluar përkohësisht për muajt shtator, tetor dhe nëntor të këtij viti.

Punëtorët e ndërmarrjes Trepça hynë në grevë në korrik deri më 14 gusht, për shkak të mosekzekutimit të pagave për muajt qershor dhe korrik, si dhe për shkak të mungesës së shujtave ditore për ushqim. Më 14 gusht, Qeveria e Kosovës



ndau 4 milionë euro për pagat e minatorëve të gjigantit metalurgjik Trepça.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, deklaroi se kjo shumë u nda për të tejkaluar krizën aktuale, pasi "ndërmarrja nuk

ka arritur t'i sigurojë pagat nga prodhimi".

Menaxhmenti i Trepçës, më 31 korrik, mosekzekutimin e pagave e kishte arsyetuar në mungesë të mjeteve financiare dhe rënie të prodhimit.

Në një situatë të ngjashme, minatorët e Trepçës e kishin gjetur veten disa herë edhe gjatë vitit të kaluar.

Në fund të muajit tetor të vitit 2023, për dhjetë ditë me radhë ata qëndruan në grevë brenda minierës pikërisht për shkak të mosrealizimit të pagave dhe ankesave për kushtet e punës. Produktet kryesore që Trepça prodhon janë koncentratet e plumbit dhe zinkut me përmbajtje të argjendit, arit dhe elementeve të tjera. Miniera e Stantërgut, që gjendet në rajonin e Mitrovicës, është vendburimi kryesor i nxjerrjes së xehes.

Kompleksi metalurgjik Trepça është shoqëri aksionare dhe 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, kurse 20 për qind janë të punonjësve të kësaj ndërmarrjeje.

Sveçla nënshkruan Udhëzimin për trajnimin e minatorëve

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se me kërkesë të Trepçës, me qëllim të rritjes së kapaciteteve nxjerrëse të xehes në Minierën e Stan Tërgut, ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ përmes së cilit mundësohet trajnimi dhe çertifikimi i minandezëve nga institucionet tona, aq sa do të jenë të nevojshëm për Trepçën. "Falënderoj grupin punues që në afat rekord kanë punuar këtë dokument të rëndësishëm që ka adresuar në plotni kërkesat e punonjësve të Trepçës. Si Qeveri do të ndërmarrim çdo hap të nevojshëm që Trepça të ngritet e të zhvillohet", ka shkruar Sveçla në "Facebook".

IKD-ja: Kosova ende pa strategji kundër korrupsionit, draft-strategjia bie ndesh me Kushtetutën

PRISHTINË, 28 GUSHT - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), ka prezantuar të mërkurën raportin e shoqërisë civile mbi zbatimin e kapitullit II (Masat Parandaluese) & kapitullit V (Rikuperimi i Pasurisë) të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në Kosovë.

Gjatë prezantimit të këtij raporti është thënë se përkundër faktit se një numër i konsiderueshëm i obligimeve të konventës janë përmbushur përmes miratimit të ligjeve, rezultatet e synuara nuk janë arritur, ndërsa Kosova ende mbetet pa një strategji kundër korrupsionit.

Arrita Rezniciq, hulumtuuese e lartë në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), ka thënë se duke mos qenë një shtet palë në



Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), Kosova nuk merr pjesë në procesin e rregullt të rishikimit të zbatimit të kësaj

konvente. "Raporti i publikuar sot gjen se përkundër faktit se një numër i konsiderueshëm i obligimeve të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër

Korrupsionit janë përmbushur përmes miratimit të ligjeve, rezultatet e synuara nuk janë arritur. Për më tepër, edhe në aspektin legjislativ, viteve të fundit ka një tendencë për regres", ka pohuar ajo, duke shtuar se përkundër se nuk është shtet palë, deri më tani, Kosova ka treguar angazhimin e saj të palëkundur për të zbatuar dispozitat këtë Konventë. "Kosova, në përputhje me obligimet kontraktuale me Bashkimin Evropian përmes Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ka ndjekur me proaktivitet politika kundër korrupsionit duke integruar dispozita përkatëse në legjislacionin dhe politikën e saj vendase. Janë miratuar ligje dhe rregullore të ndryshme për të

forcuar kuadrin institucional, për të rritur transparencën dhe për të ndjekur penalisht veprat e korrupsionit. Përkushtimi i Kosovës për të zbatuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit konsiderohet edhe me mos pretendimin për të shmangur zbatimin e dispozitave të kësaj konvente", ka thënë Rezniciq. Ndërsa Betim Musliu, zëvendës drejtori i IKD-së, ka thënë se Kosova ende nuk ka një strategji për luftimin e korrupsionit, ndërsa draft-strategjia e tanishme bie ndesh me Kushtetutën e Kosovës. Musliu ka thënë se kjo draft-strategji nuk i ndan siç duhet disa kompetenca për mbikëqyrjen e Këshillit Prokurorial e as për medie.

KESCO shpërndan faturat e rrymës në zarfe për mbi 700 mijë konsumatorë

PRISHTINË, 28 GUSHT - KESCO ka njoftuar se është duke shpërndarë faturat e energjisë elektrike të konsumatorëve në zarfe, ashtu siç e parasheh edhe vendimi i fundit nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP).

Me anë të një njoftimi, ka bërë me dije se ky projekt, i cili ka filluar së implementuari si pilot-projekt që nga muaji maj i këtij viti në disa lokalitete në formë të pilot-projektit, pastaj nga 22 qershori i këtij viti, pilot-projekti është zgjeruar në të gjitha distriktet në lokalitete të caktuara, për

të filluar me komplet konsumatorët në muajin gusht. "Kjo formë e re e shpërndarjes së faturave pa dyshim që po has në shumë vështirësi për ta implementuar në plotni. Një nga pengesat kryesore është mungesa e kutive postare, mungesa e adresave dhe numri identifikues i shtëpive apo objekteve banesore. Këto po e vështirësojnë tej mase procesin e dorëzimit të faturave", ka njoftuar KESCO. Më tutje, KESCO ka theksuar se futja në zarfe e të gjitha faturave, përpos pengesave në terren, po ngadalëson


edhe komplet procesin e leximit dhe faturimit. Të gjitha këto rrethana, sipas KESCO-s, e bëjnë të domosdoshme marrjen në konsideratë të ndonjë alternative tjetër, ku esencial do të ishte bashkëpunimi ndër-institucional që të gjendet zgjidhja sa më e mirë dhe sa më efikase, benefitet e të cilave do t'i korrnin konsumatorët fundor. "KESCO ka mbi 700 mijë konsumatorë anekënd Kosovës, dhe çështjet operacionale, sidomos në vende rurale, e vështirësojnë edhe më tepër realizimin e



këtij projekti. Kemi shqyrtuar edhe organizimin e dërgesave postare, por që nuk janë unike për të gjithë

dhe nuk krijojnë mundësi veprimi për të gjithë konsumatorët fundorë", ka njoftuar KESCO.

Nji kushtrim për kulturë



Nga: Át Anton HARAPI
(fragment nga libri *Vlerë shpirtërore*)

Në mes të këtij tufani të tmerrshëm qi po e trandë anekand jetën shqiptare, ndërsa shoh qui pacem dicunt et desolationem faciunt, ata qi n'emën t'idealit e të kombsisë nuk po lanë gja pa përmbysë, rrij e përgjoj e me kënaqësi të madhe ndiej një za zemre, gjamën e shpirtit të disa shqiptarëve vërtet fisnikë, të cilët tue u naltue mbi këtë shëmtim, mbërrijnë aty ku janë vlerat e visaret e jetës njerëzore e shqiptare, dhe me të tana ndiesitë nuk flasin, por si vigaj ulurojnë; zani i tyne asht kushtimi për kulturën e shpirtit shqiptar.

Njimend se këta janë pak, krahasue me faktorët e shkretimit, por mjaftojnë me krijue në Shqipni një rrymë jete shpirtnore.

Ju qi e dini mirëfilli se jeta shqiptare pa faktorin shpirtnuer nuk ka si me qenë, as pse me qenë; ju udhëhjeksa t'idesë e bashkëpunëtorë të mi, ju kam

grishë këtu të prekeni e të rrëmbeheni nga kjo ushtimë shpirti e, ma me të dhanun se faktorët e rrënimt, t'i përveshemi punës për rindërtimin shpirtnuer në vendin tonë.

Vallë, pse tash tridhetë e sa vjet të pamvarësisë, me të gjitha përpjekjet për kulturë, erdhëm e u vorfnuem shpirtnisht? Ky problem i madh, për mue, ka një shkak të vetëm, një spjegim të thjeshtë: rreziku i ynë pse vumë leskër kulture d.m.th. nuk morëm kulturën vetë, por morëm format e përfitimet e kulturës dhe i përshtatëm; shndërruem vlerat objektive me vlerat relative; përparuem për dukë, ndërsa realisht në shpirt borëm shumë, mbetëm mbrapa; u dhamë randësi të parë mjeteve e harruem qëllimin; tue kërkue ta bajm jetë sa ma të lehtë, shvleftësuem jetën vetë. Lavrimi i mendjes, trajtimin e vullndesës, ndiesitë e nalta shpirtnore i qitëm e i lamë në vend të dytë e të tretë. Faktori shpirtnor nuk pati vendin e vet, vendin e parë. Ja, sot në Shqipni nuk të pyetë kush shka je, por si dukesh, as nuk don të dijë kush sa pare të ban gjaku,

por sa pare ke në Bankë. Nuk po lypet të jesh i dijshtëm, as i aftë, mjaft të dijsh me u mbajtë dhe me u dukë i tillë.

Ja, misioni i parë i këtij organi kulture shqiptare: me e vu në vendin e vet faktorin shpirtnor. Landa e veprimt tonë, pra, synon naltësimin e jetës njerëzore e shqiptare ndër gurrat e faktorët e vërtetë.

Si e dini mirë, ligjet nga burojën ndikimet e shpirtit të njeriut janë tri: e vërteta, e mira dhe e bukura. Sado i vojtun keq e i dobësuem të jetë një njeri apo një popull, ai për nevojë të mbrendshme dhe të domosdoshme nuk mund t'u ikë këtyne imperativave e, mjaft qi t'i shfaqen kjarhtë, përshtatshëm, të gjallë e të prekshtëm, se ai për një ligjë të pashlyeshme mbetet preja e këtyne idealeve. Arsyeja asht se njeriu nuk asht vetëm planc për t'u ushqye, as vetëm trup për t'u veshë me mundafsh, as vetëm organizëm për të veprue në mënyrë automatike pa një shkas t'arsyeshëm, pa një qëllim të menduem. Njeriu, derisa të jetë njeri, pors i drita diellin, kërkon e ndjekë të vërtetën; ashtu edhe, në sajë


t'asaj shkëndije hyjnore qi asht liria, priret fuqishëm drejt së mirës morale. Prapë mandej njeriu nuk ndien vetëm si shtasët; ai provon në vete të vërtetën e të mirën, dhe ndien nevojën ta shprehë: kjarhtësia e së vërtetës dhe e së mirës objektive, e ndieme në shpirt dhe e shprehun me format e veprat ma të plotat, kjo asht bukuria.

Ky, shkurtazi, asht programi ynë vetjak e kolektiv si pjesëtarë të këtij Instituti: lavrimi i mendjes, i vullndesës dhe i ndjesive ndër lamije të së vërtetës, të së mirës dhe të së bukurës. Kur ta bajmë shqiptarin t'aftë qi vetë ta kërkjë, vetë ta gjejë dhe vetë ta shfaqë të vërtetën, kemi ba shkencëtarin; kur ta bajmë të zotin qi ai vetë t'i vendojë parimet e drejta të jetës dhe këtyne t'u rrijë me dijtë ç'me dijtë, e kemi çue shqiptarin në kulmin e mirësisë: kemi ba fatosin, qi me fuqin e vullndesës përfton vepra morale të rendit botnor. Tue ia mprehë shqiptarit ndjesitë, e bajmë të mbërrijë me ndie në shpirt shfaqjet e së vërtetës dhe të mirësisë, atëherë ai përket, tërhiqet, rrëmbehet,

atëherë shpirti i tij jipet, përpiqet, as nuk pushon derisa të gjejë format e mjaftueshme për t'i shprehë ato madhni, ato ideale fisnike për të cilat rron. Dhe ja, kemi ba artistin.

Kjo asht kultura e shpirtit, kultura e vërtetë. Fjala latine colere, prej së cilës rrjedh fjala kulturë, na tregon haptas se n'atë mënyrë si toka, sado e çmueshme të jetë, po u la djerrë, nuk jep fryt, ashtu edhe shpirti i shqiptarit, sado të ngrehet ndër automobila, sado të veshet me petka të bukura e me ar, sado të kërtyllet me pare e pasuni, sado t'i ngjeshë vetes forma të hijshme dhe të kandshme, ka për të mbetun djerrë, ka për të mbetun i egër, barbar, i paaftë për fryte njerëzore, në qoftë' se nuk lëvrohet ndër fuqitë e mendjes, të vullndesës e të ndjesive, në qoftë se nuk bahet i aftë për vepra të mëdha ditunie, morali dhe arti. Për këtë arsye, unë tanë veprën e kësaj organizate shqiptare due ta përmbledh e ta shpreh me një fjalë të vetme: pro cultura.

Fruer 1944



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Shkëndija konfirmon ndarjen me Krasniqin

TETOVË, 28 GUSHT - Shkëndija e Tetovës ka konfirmuar se është arritur marrëveshja për shkëputjen e bashkëpunimit me mesfushorin nga Kosova, Endrit Krasniqi. Mesfushori në fjalë është ndarë me klubin kuqezi dhe tani e tutje ai do të jetë lojtarë i lirë, ku me shumë mundësi pritet rikthimi i tij në Kosovë. Faqja zyrtare e Shkëndijës, e cila ka konfirmuar ndërprerjen e bashkëpunimit me Krasniqin, shkaku i arsyeve familjare të lojtari. “KF Shkëndija njofton se është

arritur marrëveshje e përbashkët për t’u ndarë me mesfushorin Endrit Krasniqi, pas kërkesës së tij për ndërprerjen e parakohshme të kontratës për arsye familjare. Në këto momente, KF Shkëndija ka treguar mirëkuptim dhe ndjeshmëri, duke e vendosur gjithmonë mirëqenien e lojtarit në plan të parë. Vendimi për t’i ofruar Endritit mbështetjen e nevojshme dhe lirinë për të qenë pranë familjes së tij është një dëshmi e vlerave të larta jo vetëm sportive që klubi ynë

përfaqëson”, thuhet në njoftimin e Shkëndijës. “Ne falënderojmë Endritin për përkushtimin dhe kontributin gjatë qëndrimit të tij me Shkëndijën. Krasniqi ishte pjesë e rëndësishme e ekipit tonë, dhe ne i urojmë gjithë të mirat në të ardhmen, duke shpresuar që rrugët tona do të kryqëzohen sërish në të ardhmen. KF Shkëndija mbetet e përkushtuar ndaj objektivave për këtë sezon dhe do të vazhdojë të punojë për të arritur sukses”, thuhet në njoftimin e klubit tetovar.



Rritet në tetë numri i lojtarëve të huaj që mund të luajnë për një klub

Komiteti Ekzekutiv së fundmi ka miratuar një ndryshim të rëndësishëm në Rregulloren e Garave të Super Ligës dhe Ligës së Parë. Është vendosur që tani e tutje të rritet numri i lojtarëve të huaj që luajnë gjatë së njëjtës kohë. Ky numër është rritur nga gjashtë në tetë. Ky vendim ka ardhur pas kërkesave të klubeve, me qëllim të

përmirësimit të kushteve dhe cilësisë së garave në vend. “Pas një analize të hollësishme dhe në përputhje me kërkesat e vazhdueshme të marra nga klubet pjesëmarrëse në garat e organizuara nga Federata e Futbollit e Kosovës, konform statutit të FFK-së, Komiteti Ekzekutiv si organ kompetent ka miratuar një ndryshim të

rëndësishëm në Rregulloren e Garave të Super ligës dhe Ligës së Parë”. “Konkretisht, është vendosur që të rritet numri i lojtarëve të huaj të lejuar të aktivizohen njëkohësisht në fushën e lojës, nga deri gjashtë (6) lojtarë të huaj siç ishte e paraparë më parë, tani në deri në tetë”, thuhet në e-mailin e dërguar klubeve.

SHKURT

Vojvoda, afër rinovimit të kontratës me Torinon

Mbrojtësi i Kosovës, Mërgim Vojvoda është afër rinovimit të kontratës me Torinon. Kështu ka raportuar “Sky Sport” i Italisë. Sipas sajtit italian, mbrojtësi i krahut ka arritur marrëveshje për vazhdimin e kontratës deri në vitin 2027 me mundësi vazhdimi edhe për një vit. “Roli i Vojvodës në ekipin e Torinos është shumë i rëndësishëm. Ai po paraqitet me shumë sukses në të dyja krahët e mbrojtjes te Torino. Kontributi i tij po vlerësohet edhe në fazën e sulmit”, shkruan “Sky Sport”. Vojvoda po luan rregullisht në vitet e fundit te Torino. Skuadrës elitare të Italisë iu bashkua në vitin 2020. Për Kosovën nga viti 2017 ka luajtur 51 ndeshje, ndërsa ka shënuar dy gola.

Learta Muharremi fiton turneun ndërkombëtar “Peja Open” për U-14

Tentistja nga Mitrovica, Learta Muharremi, ditë më parë e fitoi turneun ndërkombëtar “Peja Open” për U-14. Muharremi në një prononcim për Telegrafin ka thënë se rrugëtimi deri këtu ka qenë i bukur, i gjatë dhe jo i lehtë. Ajo ka thënë se nga viti 2020 e ka pasur vetëm një humbje në kategorinë e saj përkatëse ku ajo luan me grupmoshat e veta. Tenistja mitrovicase ka treguar disa nga çmimet që i ka fituar ndër vite. Në vitin 2020, Muharremi e ka fituar çmimin “Shpresë e vitit” për kategorinë U-10, në vitin 2021, “Tentiste e vitit” për kategorinë U-12. Ndërsa, në vitin 2022 e fitoi çmimin “Teniste e vitit” për kategorinë U-12 dhe U-14 dhe në vitin 2023, “Teniste e vitit” për kategorinë U-14 dhe U-16. “Në këtë turne pjesëmarrëse ishin gjithsej 19 garuse, vajza nga vende të ndryshme të Evropës”, ka thënë ajo. Tenistja nga Mitrovica ka treguar se me këtë sport ka filluar të merret që nga mosha 9-vjeçare dhe se ambiciet e saj për të ardhmen janë që të jetë pjesë e turneve si “Wimbeldon”, “US Open”, “Australia Open” e të tjerë. Tutje, Muharremi është shprehur se deri më tani nuk e ka pasur mbështetjen e duhur nga Federata e Tenisit të Kosovës dhe nga institucionet qendrore e komunale.

Cancelo prezantohet te Al Hilali

Joao Cancelo është lojtari më i ri i Al Hilal në Arabinë Saudite. Njoftimi zyrtar ka ardhur nga vetë klubi, që ka bërë edhe prezantimin e futbollistit portugez. Ky operacion u ka kushtuar arabëve plot 79 milionë euro, të ndara në 25 milionë euro për të blerë kartonin e lojtarit dhe një kontratë 3-vjeçare, nga e cila mbrojtësi do të përfitojë 54 milionë euro. Në sezonin e fundit, Cancelo luajti në huazim te Barcelona, me katalanasit që provuan të blejnë kartonin e portugezit, por ishin larg kërkesave të Manchester Cityt, të cilat u plotësuan nga Al Hilal.

Orari i çerekfinaleve të Superkupës në basketboll

Prizren, 28 gusht - Qyteti i Prizrenit do të jetë mikpritës i Superkupës së Kosovës në basketboll. Spektakli i basketbollit do të fillojë në qytetin e bukur dhe historik. Pasi janë caktuar çiftet çerekfinale, tashmë dihet

edhe orari i ndeshjeve, që zhvillohet më 7 dhe 8 shtator. Më 9 shtator do të zhvillohen ndeshjet gjysmëfinale, derisa finalja më 11 shtator. Në ndeshjet çerekfinale, fituesja e Kupës, Superkupës, por edhe kampionia Trepça do të

ndeshet me Borën, që ka hyrë nga Liga e Parë, derisa Sigal Prishtina do të ndeshet me Vëllaznimin. Të dielën sfidë interesante shihet mes Pejës dhe Proton Cable Prizrenit dhe Golden Eagle Yllit e Bashkimit.

ORARI

Më 7 Shtator takohen:
17:00 Trepça - Bora
20:00 Sigal Prishtina - Vëllaznimi

Më 8 Shtator takohen:
17:00 Peja - Proton Cable Prizreni
20:00 Golden Eagle Ylli - Bashkimi



Dy stadione në Suedi do të mbajnë emrin e Erikssonit

Gothenburg, 28 gusht - Suedia ka vendosur të përjetësojë Sven-Goran Eriksson. Në respekt të karrierës së tij si trajner, emri i tij do të vendoset në dy stadione, në Degerfors dhe Goteborg. Suedia ende po qan për humbjen e ish-trajnerit të

futbollit Sven-Goran Eriksson. E për ta përjetësuar atë dhe karrierën e ndritur që pati si trajner, shteti suedez po mendon t'i vendosë emrin e tij dy stadioneve. Në stadiumin Degerfors por edhe në Ullevi në Goteborg, ku trajneri u zbulua, pasi fitoi Kupën UEFA

në 1982 me Ifk, klubin e qytetit. Eriksson numëron një karrierë fantastike, e cila filloi në Goteborg me triumfin në Evropë 42 vjet më parë. Dhe kështu bota filloi të flasë për të, për këtë trajner të ri suedez. Karriera e të cilit filloi të ngjite shkallët një e nga duke

drejtuar skuadra të mëdha evropiane. Gazetat suedeze dhe lajmet televizive kanë folur pothuajse ekskluzivisht për vdekjen e Eriksson ditët e fundit, duke përmendur edhe karrierën e tij italiane. Shumë u fol edhe për faktin se Eriksson mbeti gjithmonë një



zotëri, i përlulur, i qetë e me këmbë në tokë. E me të drejtë emri i tij pritet të përjetësohet në dy stadione të Suedisë

Klaus Gjasula vendos të tërhiqet nga Kombëtarja e Shqipërisë

TIRANË, 28 GUSHT - Klaus Gjasula ka marrë vendimin për t'u tërhequr nga Kombëtarja shqiptare. Mesfushori luftarak ka biseduar me trajnerin Silvinho dhe stafin teknik, duke i komunikuar vendimin e tij. Gjasula numëron 29 ndeshje me Kombëtaren, duke debutuar më 7 shtator 2019 në ndeshjen Francë-Shqipëri, ndërsa ishte pjesë e Shqipërisë në Kampionatin Evropian "Gjermani 2024", aty ku gjeti edhe rrugën e rrjetës për herë të parë me fanellën kuqezi në sfidën e paharrueshme Kroaci-Shqipëri, që përfundoi në barazim 2-2. Sakaq, me anë të një postimi në rrjetet sociale futbollisti ka bërë të ditur vendimin e tij, duke u shprehur se për të ka qenë gjithmonë një ëndërr të luante dhe të përfaqësohte denjësisht Shqipërinë në arenën ndërkombëtare, ndërsa shton se është vendimi i duhur për t'u hapur rrugën të rinjve. "E kisha ëndërruar gjithmonë të luaja me Kombëtaren dhe e realizova. Isha në një Evropian, shënova një gol dhe u ndjeva njeriu më i lumtur.



Nëse ktheh kokën pas, kam plot momente të bukura me fanellën kuqezi, që nga grumbullimi i parë, te ndeshja debutuese ndaj Francës në 'Stade de France' dhe tek ajo e fundit ndaj Kroacisë në Evropian. Edhe kur e mendoj tani ende dridhem nga emocionet. Gjithsesi, me ftohtësi kam gjykuar dhe kam marrë vendimin për t'u tërhequr nga Kombëtarja. Është vendimi i duhur për t'u hapur rrugën të rinjve, që Kombëtarja jonë fatmirësisht ka shumë. Unë e realizova ëndërrën time dhe tani është koha për të tjerë që ta plotësojnë dhe ta jetojnë atë ëndërr", ka thënë Gjasula. "Pas pesë vitesh do të kem mundësinë të vij në stadium dhe ta mbështes Kombëtaren tonë si tifoz. I jam

falënderues Zotit, familjes time dhe të gjithë njerëzve që më kanë qëndruar pranë në çdo moment dhe kanë besuar tek unë. Në veçanti dua të falënderoj edhe Federatën Shqiptare të Futbollit, Presidentin Armand Duka, trajnerët më të cilët kam punuar, Edoardo Reja dhe Sylvio Mendes Campos Junior, stafin teknik të Kombëtares dhe të gjithë bashkëlojtarët që ndamë këtë rrugëtim, që për mua është më i veçanti. Sukseset e arritura nuk do të ishin të mundura pa tifozët më të mirë në botë, ata të cilët na kanë mbështetur gjithmonë, si në humbje, fitore apo barazim. Faleminderit nga zemra të gjithë tifozëve kuqezi. Për mua ishte nder dhe krenari të vishja fanellën e Kombëtares!", ka shtuar Gjasula. Federata Shqiptare e Futbollit e falënderon dhe i shpreh mirënjohjen mesfushorit për kontributin e dhënë në fushën e lojës me fanellën kuqezi në gjithë këto vite, ku ka spikatur gjithmonë për grintën, profesionalizmin dhe përkushtimin e tij të pakursyer në çdo sfidë.

SHKURT

Alcaraz dhe Sinner triumfojnë në sfidat e para të US Open, eliminohet Tsitsipas

Janë luajtur ndeshjet e fundit të raundit të parë në grand slam të US Open në tenis. Në fushat me çiment të Nju Jorkut, tenisti spanjoll Carlos Alcaraz fitoi 3-1 ndaj Li Tu (6-2, 4-6, 6-3, 6-1), duke avancuar më tej. Po 3-1 fitoi edhe numri 1 në botë, italianin Jannik Sinner (2-6, 6-2, 6-1, 6-2) ndaj Mackenzie McDonald. Surprizë eliminimi grekut Stefanos Tsitsipas, që u mund 3-1 nga Thanasi Kokkinakis. Në raundin e dytë shkon edhe rusi Daniil Medvedev, që eliminoi serbin Dusan Lajović, ndërkohë që u eliminua veteran Stanislas Wawrinka. Te femrat, një biletë për më tej siguron tenistja amerikane Jessica Pegula, ndërkohë që fitore me përmbysje arriti tenistja italiane Jasmine Paolini. Fitore edhe për tenisten japoneze Naomi Osaka, që avancoi më tej.

Vdes futbollisti katër ditë pasi kolapsoi në fushë

Futbollisti uruguaijan, Juan Izquierdo, ka vdekur katër ditë pasi kishte pësuar arrest kardiak në fushë. Lajmin për vdekjen e tij e ka bërë të ditur klubi i lojtarit, Nacional, përmes një postimi në X. "Me dhimbjen dhe shokun më të madh në zemër Klubi Nacional de Football njofton për vdekjen e lojtarit tonë të dashur Juan Izquierdo", thotë njoftimi. Mbrojtësi vdiq të martën në Spitalin Albert Aynshtajn të Sao Paulos pas katër ditëve të kaluara në gjendje kritike.

Flick: Ja pse Olmo është pjesë e jona

Barcelona arritur fitore ndaj Vallecans në La Liga, derisa trajneri Hansi Flick është shfaqur i lumtur me tri pikët e radhës. Në këtë ndeshje debutoi edhe Dani Olmo me gol, kurse tekniku gjerman ka thënë se kjo është arsyeja pjesë ai është pjesë e Barçës. "Ja sepse Dani Olmo është pjesë e jona. Minutat e para të ndeshjes nuk ishin të mira për ne, nuk u paraqitem mirë, por në pjesën e skuadra bëri një ndeshje të madhe. Vitet e fundit kishim vuajtur gjithmonë ndaj Vallecans, por sonte arritëm ta menaxhim si duhet takimin, arritëm të kombinonim mirë duke siguruar tri pikët", ka thënë Flick.

Lukaku, lojtar i ri i Napolit

Romelu Lukaku do të ribashkohet me Antonio Conte në Napoli. Klubi italian ka arritur marrëveshje me Chelsea për transferimin e sulmuesit belg, në shifrën e 30 milionë eurove. Lukaku ka zbkuar në aeroportin "Ciampino" të Romës së bashku me agjentin e tij Federico Pastorello dhe për të është planifikuar menjëherë transferimi në Villa Stuart, ku do të kryejë vizitat mjekësore përpara se të udhëtojë drejt Napolit. Sulmuesi pritet të nënshkruajë kontratën që do ta lidhë atë me ekipin e De Laurentiis deri në vitin 2027. Chelsea përveç 30 milionë eurove do të ruajë edhe 30% të kartonit të Lukakut në rast se Napoli e shet te një klub tjetër. Për Lukakun është një rikthim në Itali, pasi sezonin e kaluar mbajti veshur fanellën e Romës me të cilën shënoi 21 gola në 47 ndeshje, duke dhënë edhe 3 asistime.

Kane mori çmimin 'Këpuca e Artë': Jam në kulmin e karrierës

Munchen, 28 gusht - Sulmuesi i Bayern Munchen, Harry Kane mori çmimin "Këpuca e Artë 2023/24", e fituar gjatë sezonit të futbollit evropian që përfundoi qershorin e kaluar. Sulmuesi anglez mori rezultatin më të mirë të llogaritur duke shumëzuar numrin e golave të shënuar në ndeshjet e kampionatit me koeficientin e vështirësisë së vetë kampionatit (x2): 72 pikë nga 36 gola. Kane, la pas Guirassy (28 gola/56 pikë me Stuttgartin) dhe Mbappe (27 gola/54 pikë me PSG). "Ky çmim më bën krenar dhe më shpërblen për të gjitha përpjekjet, për atë që shihni dhe atë që nuk shihni. Duhet të falënderoj Bayernin, shokët e mi të skuadrës, stafin, tifozët, familjen, ata që bënë të mundur këtë. Është një çmim



për të gjithë, për angazhimin e të gjithëve", ka thënë Kane. Ai i bashkohet një grupi të zgjedhur legjendash, duke përfshirë Messin, Cristiano Ronaldon, Ronaldon, Gerd Muller, Eusebio, por Këpuca e Artë nuk ishte qëllimi i Kane: "Nuk do të thosha se ishte ëndërra ime të fitoja këtë çmim. Ëndërra

ime e vërtetë ishte të luaja futboll në nivelin më të lartë të mundshëm. Pra, të jesh pjesë e një grupi me këta emra, ndër lojtarët më të mirë ndonjëherë, është diçka e veçantë. Fizikisht dhe mendërisht ndihem sikur jam në momentin më të mirë të karrierës sime".

Liverpooli arrin marrëveshje personale me Chiesan

Liverpooli thuhet se veçse ka arritur marrëveshje personale me italianin Federico Chiesa dhe tashmë po beson me Juventusin për të gjetur akordin për çmimin e lojtarit. Eksperti i transferimeve, Fabrizio Romano

ka raportuar të mërkurën dhe "Reds" dhe Chiesa kanë përfunduar pothuajse marrëveshjen. "Marrëveshja me Federico Chiesa dhe Liverpool për kushtet personale është pothuajse e përfunduar!

Detajet përfundimtare po zgjidhen sot. Kontrata katër-vjeçare gati pas bisedimeve fillestare të zbuluara ekskluzivisht të hënën. Juventus dhe Liverpool në bisedime të drejtpërdrejta për të arritur një

marrëveshje për tarifën", ka shkruar Romano. Më parë u raportua se Juventus kërkon 15 milionë euro për italianin, kontrata e të cilit skadon në fund të këtij sezoni. Liverpooli në anën tjetër ka dërguar ofertën e

parë drejt Zonjës së Vjetër e cila peshon 12 milionë euro dhe diferenca nuk është e madhe. Sulmuesi i krahut të majtë ka bërë 131 paraqitje për gjigantët e Serie A, duke shënuar 32 gola dhe duke dhënë 23 asistime.



Prishtinë 10000 Kosovë. Rruza "TIRANA" nr. 125 Tel. +383 (0) 38 613 026

Numër: 1316 /1

Datë: 28.08.2024

Bazuar në nenin 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/1 – 138, i datës 28.02.2013 për arsimin dhe aftësimin profesional dhe në bazë të nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L – 143, i datës 13.12.2012, për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe në bazë të rregullores (MASHT) nr. 01/2017, të datës 02.02.2017, për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave nga kjo formë arsimit, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, shpall :

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) për vijimin e mësimin për të rritur në Qendrën e Kompetencës "SHTJEFËN GJEÇOVI" në Prishtinë, për vitin shkollor 2024/2025, afati i Janarit.

Për këto profile :

- Dirigjimi kompjuterik i makinave
- Metalpunues
- Operator Prodhimi
- Automekanik
- Mekatronikë
- Instaluesi i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ngrohjes dhe klimatizimit
- Floktari
- Konfeksioner
- Rrobaqepës
- Transport rrugor
- Trafik rrugor
- Transporto hekurudhor (Drejtues i trenave, Lëvizje e trenave, Tërheqje e trenave).

KUSHTET :

Regjistrimi i vijuesve në programin arsimit për të rritur bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt siç është paraparë në Ligjin nr.04/L – 143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve të MASHT-it, UA 11/2011, UA 16/2011 i datës 30.12.2011 ; UA 12/2014, i datës 05.05.2014, dhe UA 13/2014, i datës 05.05.2014.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët kanë moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Dëftesa e klasave të kryera paraprake
- Certifikata e lindjes
- Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të UA 11/2011, i datës 30.12.2011.

Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:


- | | |
|--|----------|
| a) Për regjistrim të vitit për një klasë | 100,00 € |
| b) Për praktikë profesionale | 50,00 € |
| c) Për provim diferencial | 10,00 € |
| d) Provimi përfundimtar /certifikata – diploma | 50,00 € |

Pagesat bëhen në institucionet financiare sipas kodit të shkollës.

Dëftesat dhe diplomatat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" janë të barasvlershme me diplomatat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Blerim Gërvalla



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Leonora Haxhibeqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 të SH.M.M. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Erblina Duraku shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Halim Hoti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Bajram Curi " Krushe e Madhe.

- Florent Aliu shpall të humbur dëftesën e kl. së dymbëdhjetë të shkollës së mesme Medreseja "Alaudin" Prishtinë.

- Danjella Keqani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl, X të shkollës së mesme "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

